


# LegalNews

February 2023  
Shkurt 2023

## **SPECIAL**



**Deloitte.**

## Rregullorja për Ushtrimin e Veprimtarisë dhe Mbikëqyrjen e Institucioneve të Parasë Elektronike.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar Vendimin Nr. 57, datë 21.12.2022 "Për Miratimin e Rregullores "Për Ushtrimin e Veprimtarisë dhe Mbikëqyrjen e Institucioneve të Parasë Elektronike" (në vijim "**Rregullorja IPE**").

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, për administrimin e rreziqeve që lidhen me këtë veprimtari, mbikëqyrjen e tyre, si dhe i rregullave dhe kërkesave për emetuesit e parasë elektronike (në vijim "**Emetuesit**").

Subjekt i kësaj rregulloreje janë institucionet e parasë elektronike si dhe bankat/degët e bankave të huaja në cilësinë e emetuesit të parasë elektronike.

Disa nga parashikimet kryesore të Rregullores IPE janë të përmbledhura si më poshtë:

### I. Sistemi i administrimit të rrezikut

- Institucionet e parasë elektronike krijojnë dhe zhvillojnë sistemin e administrimit të rrezikut, lidhur me veprimtaritë/shërbimet për të cilat janë licencuar, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë/shërbimeve të tyre.
- Rreziqet që lidhen me veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në: rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut, rrezikun e pastrimit të parave ose financimit

## The Regulation on the Activity and Supervision of Electronic Money Institutions

The Supervisory Board of the Bank of Albania has approved Decision No. 57, dated 21.12.2022 "On the Approval of the Regulation "On the Activity and Supervision of Electronic Money Institutions" (hereinafter "**EMI Regulation**").

The object of this regulation is to determine the rules for the activity of electronic money institutions, risks management related, supervision, as well as the rules and requirements for issuers of electronic money (hereinafter "**Issuers**").

Subject to this regulation are electronic money institutions as well as banks/branches of foreign banks in the capacity of the issuer electronic money.

Some of the main provisions of the EMI Regulation are summarized as follows:

### I. Risk management system

- Electronic money institutions create and develop a risk management system, related to the activities/services for which they are licensed, in accordance with the nature, volume and complexity of their activities/services.
- Risks related to the activity of issuing electronic money may include, but are not limited to: operational risk, market risk, liquidity risk, money laundering or financing of terrorism risk, exchange rate risk.

të terrorizmit, rrezikun e kursit të këmbimit.

- Funkzioni/njësia e kontrollit të brendshëm siguron në mënyrë të pavarur cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit, si dhe mbi sistemin dhe proceset e drejtimit/qeverisjes dhe të administrimit të rreziqeve.

- The internal control function/unit independently ensures the effectiveness of the internal control system, as well as on the management/governance and risk management system and processes.

## II. Kërkesat për kapital dhe Mbrojtja e Fondeve

- Institucioni i parasë elektronike siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit, për ushtrimin e veprimtarisë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.
- Kapitali rregullator i institucionit të parasë elektronike, në çdo kohë, nuk mund të bjerë nën shumën e kapitalit fillestar minimal.
- Institucioni i parasë elektronike mbron të gjitha fondet e pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike në vlerën e teprcës së parasë elektronike.
- Fondet e mbajtësve të parasë elektronike (përdoruesi) nuk duhet të bashkohen në asnjë rast me fondet e vetë institucionit të parasë elektronike apo të ndonjë personi fizik apo juridik, të ndryshëm nga mbajtësit e parasë elektronike në emër të të cilëve janë mbajtur fondet.
- Fondet e mbajtësve të parasë elektronike do të mbulohen nëpërmjet një police sigurimi ose ndonjë garancie tjetër të njëjtë me të nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë, e cila nuk i përket të njëjtit grup bankar/financiar të institucionit të parasë elektronike.

## II. Capital Requirements and Protection of Funds

- The electronic money institution ensures sufficient levels of capital, for exercising safe and sustainable activity, as well as for the fulfillment of its obligations during the day-to-day activity.
- The regulatory capital of the user of electronic money, at any time, cannot fall below the amount of the minimum initial capital.
- The electronic money institution protects all funds received in exchange for issuing electronic money in the value of the electronic money surplus.
- The funds of electronic money holders (the user) must not be combined in any case with their own funds, or of any natural or legal person, other than the holders of electronic money on behalf of which the funds are kept.
- Funds of electronic money holders will be covered through an insurance policy or other similar guarantee with an insurance company or by a bank, which is not affiliated with the same banking/financial group of electronic money companies.

### III. Dhënia e kredive në lidhje me shërbimet e pagesave

- Institucionet e parasë elektronike mund të japin kredi në lidhje me shërbimet e pagesave, nëse plotësohen në mënyrë kumulative një sërë kushtet të parashtruara në Rregulloren IPE, ndër të tjera:
  - a. institucionet e parasë elektronike hartojnë dhe miratojnë rregullore të brendshme, me qëllim administrimin e rrezikut të kredisë;
  - b. kredia do të jepet nga fondet e vetë institucionit të parasë elektronike dhe jo nga fondet e marra ose të mbajtura nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave, me qëllim ekzekutimin e një transaksioni pagese;
  - c. kredia është afatshkurtër dhe duhet të shlyhet brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

### IV. Emetimi i parasë elektronike dhe Ripagimi i fondeve

- Emetuesi, emeton para elektronike për një vlerë të barabartë me vlerën nominale (*at par value*) të fondeve të marra nga mbajtësi i parasë elektronike.
- Emetuesi, me kërkesë të mbajtësit të parasë elektronike, i ripaguan atij, në çdo moment dhe në vlerë nominale, vlerën monetare të parasë elektronike të mbajtur prej tij.

### III. Granting of loans related to payment services

- Electronic money institutions may grant loans related to payment services, if several conditions as set forth in the EMI Regulation are cumulatively met, including but not limited to:
  - a. electronic money institutions draft and approve internal regulations, in order to manage credit risk;
  - b. the loan will be granted from the funds of the electronic money institution itself and not from the funds received or held by the users of the payment services, in order to execute a payment transaction;
  - c. the loan should be short-term and must be repaid within a period not longer than 12 (twelve) months.

### IV. Issuance of Electronic Money and Repayment of Funds

- The issuer, issues electronic money for a value equal to the nominal value (*at par value*) of the funds received by the electronic money holder.
- The issuer, at the request of the electronic money holder, repays him, at any time and in nominal value, the monetary value of the electronic money held by the latter.

- Emetuesi i parasë elektronike ndalohet t'i paguajë interes ose ndonjë përfitim tjetër mbajtësit të parasë elektronike, për periudhën gjatë së cilës ky i fundit mban paranë elektronike.

## V. Raportimi

- Institucionet e parasë elektronike raportojnë sipas kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore, ndër të tjera, dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël mbi baza individuale dhe të konsoliduara.
- Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në legjislacionin për bankat për shërbimet e pagesave.

**Ky Vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 2, datë 05.01.2023 dhe ka hyrë në fuqi në 01.03.2023.**

- The issuer of electronic money is prohibited from paying interest or any other benefit to the holder of electronic money, for the period during which the latter holds the electronic money.

## V. Reporting

- Electronic money institutions report according to the requirements defined in the applicable legislation, *inter alia*, they have the obligation to send to the Bank of Albania, within the first 6 (six) months of the following year, a copy of the annual report and the opinion of the authorized accounting expert, which reflects financial and accounting position, on an individual and consolidated basis.
- The Bank of Albania, in case of non-fulfillment of the requirements of this regulation, applies the supervisory and/or disciplinary measures provided for in the legislation for banks and for payment services.

**This Decision has been published in Official Gazette No. 2, dated 05.01.2023 and has entered into force on 01.03.2023.**

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,  
Ish parku i mallrave,  
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3  
1001, Tirana, Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Sabina Lalaj**

Local Legal Partner  
Deloitte Legal sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,  
Ish parku i mallrave,  
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3  
1001, Tirana, Albania  
Mob: +355 68 37 33 130  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

## **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing’s affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte’s approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.